

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “SHOKO-MERT” SHPK

Bazuar ne Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr.9723, date 03.05.2007, “Per Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ligjit nr.131/2015, date 26.11.2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, une i nenshkruari,

MEHMET BAKIU, i biri i Ismailit dhe Fatbardhes, lindur me 24.05.1989 ne Kucove dhe banues ne Lucie Bekerdheli 00690483; Nd. 27; H. 1; Durres, Shqiperi, identifikuar me Leternjoftim nr. 034547488 dhe Nr. Personal I90524076T, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

ne cilesine e Ortakut te Vetem, sot me date **11 prill 2023**, dite e Marte, ne Tirane, shpall themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar “Shoko-Mert sh.p.k.”, nepermjet ketij akti themelimi dhe miratoj statutin e kesaj shoqerie me permbajtje si me poshte vijon:

TITULLI I

EMRI I SHOQERISE – REGJIMI JURIDIK – SELIA – KOHEZGJATJA

NENI 1

Emertimi tregtar

1.1 Emertimi tregtar i shoqerise eshte “SHOKO-MERT” SHPK

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

NENI 2

Regjimi juridik i shoqerise

2.1 “Shoko-Mert” eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj.

NENI 3

Selia e Shoqerise

3.1 Selia e shoqerise do te jete ne adrese: Njesia Administrative Nr.7, Rruga “Kavajes” Condor Center, Kati 1, Njesia Nr.16, Tirane, Shqiperi.

3.2 Shoqeria mund te themeloje dege dhe filiale ne te gjithe territorin e vendit si dhe jashte tij, me miratimin e organeve kompetente dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto dege.



NENI 4
Kohezigjatja e Shoqerise

Kohezigjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Ortaku/et mund te vendos/in te kufizojne kohezigjatjen e aktivitetit me nje Vendim Asambleje te Pergjithshme.

TITULLI II
OBJEKTI

NENI 5
Objekti i Veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te perfshije por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarine e meposhtme:

1. Bar-kafe, lounge restorant;
2. Aktivitete argetuese per femije dhe te rritur;
3. Importim dhe tregtim i artikujve te ndryshem;
4. Importim dhe tregtim automjetesh, qeradhenie automjetesh ;
5. Marketing online;
6. Aktivitete te tjera te cilat nuk jane te ndaluara me ligj, por qe sjellin perfitime dhe jane ne interes te shoqerise.

TITULLI III
KAPITALI I SHOQERISE – TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

NENI 6
Kapitali i Shoqerise

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 kuote (pjesë), me vlere 100 (njqind) leke. Kapitali themeltar eshte 100 % kontribut i ortakut te vetem. Kontributi i nenshkruar i kapitalit nuk eshte paguar.
- 6.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose per rritjen e kapitalit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.
- 6.3 Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise perballohen deri ne vleren e papaguar te kapitalit te nenshkruar. Per detyrimet e tjera te shoqerise ortakut nuk mban pergjegjesi.

NENI 7
Transferimi i kuotave

- 7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 me poshte.
- 7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij,Ortaket e mbetur do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohet per transferim ("Kuota e Ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:



a- Ofruesi do duhet t'i njoftoje ortakët e tjere ne se do te kete shoqeria, me leter rekomande me konfirmim marrje ne dorzim, mbi synimin per shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emerit dhe afatet e transferimit;

b- Ortaket, do te kene ne dispozicion 15 (pesembedhjet) dite nga marja e letres rekomande me konfirmim marrje ne dorzim, per t'i komunikuar ortakut qe transferon pjeset e kapitalit, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes;

c- Ne rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjeset e kapitalit te ofruara nga ortakët qe transferon pjeset e kapitalit, do te ndahen nga ortakët pranues, ne mase propocionale me pjeset qe ata zoterojne, perveç rastit kur ka nje marreveshje te ndryshme ndermjet paleve. Ne asnje rast, pranuesi i ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes;

d- Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjeset e kapitalit mund t'i transferohen te tereve plotesisht apo pjeserisht.

7.3 Transferimi i kuotave ne rruge trashegimie behet sipas neneve 73, 74, 75 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar. Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Kuotat prej 1 (nje) leke jane te pandashme.

Neni 8

Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment me vendim te Asamblese se Pergjithshme me ane te kontributeve ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre.

8.2 Ne rast rritje te kapitalit, ortakët ka te drejte te nenshkruaje rritjen ne pjeset e kapitalit te zvogeluara prej tij.

8.3 Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 9

Zvogelimi i kapitalit themeltar

9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese Pergjithshme. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuara nga ligji.

9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga ortakët ne te njejten mase me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tij.

NENI 10

Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga Ortaket gezon te drejten e nje certificate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certificate per kuotat e mbajtura se bashku nga disa Ortakë dhe shperndarja e certificate per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithë Ortakëve, ne perputhje me dispozitat e Ligjit.

TITULLU IV

ORGANET E SHOQERISE

NENI 11

Organet Drejtuese te Shoqerise

- 11.1 Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj, te cilat jane:
- i) **Asambleja e Pergjithshme** eshte Organi Vendimmarres i Shoqerise e cila perbehet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise, qe ne momentin e themelimit te shoqerise dhe deri ne pranimin e ortakeve te rinj perbehet nga Ortaku i Vetem i Shoqerise.
 - ii) **Administratori**.

Neni 12

Asambleja e Pergjithshme dhe kompetencat e saj

- 12.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme.
- 12.2 Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te me poshteme:
- 12.2.1 Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
 - 12.2.2 Ndryshimin e statutit.
 - 12.2.3 Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
 - 12.2.4 Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
 - 12.2.5 Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne pikat 12.2.3 dhe 12.2.4 te ketij neni.
 - 12.2.6 Mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
 - 12.2.7 Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecjes se veprimtarise.
 - 12.2.8 Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
 - 12.2.9 Pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
 - 12.2.10 Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
 - 12.2.11 Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
 - 12.2.12 Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
 - 12.2.13 Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 13

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
- 13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori apo ortaket e percaktuar sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 84.
- 13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret ne se sipas bilancit vjetor apo raporteve financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkushme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 13.4 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 50% te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- 13.5 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 50% e aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

 4

13.6 Asambleja e Pergjithshme per rastet e parashikuara ne piken 13.3 dhe 13.5 te ketij neni i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur. Dispozitat e pikes 13.3 dhe 13.5 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet sipas ketyre parashikimeve kryhen ne burse, ose jane pjese e veprimeve te perditeshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.

13.7 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike duhet te permbaje vendin, daten, oren, e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se 7 dite para dates se parashikuar te mbledhjes se asamblese.

13.8 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te nenshkruhen nga kryetari i asamblese dhe nga sekretari.

Neni 14 Perfaqesimi ne Asamble

14.1 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

14.2 Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

14.3 Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjen vijuse me te njejtin rend dite.

Neni 15 Kuorumi per marrjen e Vendimeve

15.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

15.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

15.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne piken 12.1 me larte, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 16 Marrja e vendimeve nga Asambleja e Pergjithshme

16.1 Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres per:

- ndryshimin e statutit,
- zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- shperndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

16.2 Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;

 5

- emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - percaktimin e shperblimeve
 - mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 16.3 Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 17 **E drejta e votes**

- 17.1 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, çdo kuote jep te drejten e nje vote.
- 17.2 Ortaket, ne se do te kete, qe nuk jane te pranishem ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme kane te drejte te marrin pjese me mjete te ndryshme komunikimi perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet indetifikimi i ortakeve.
- 17.3 Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:
- 17.3.1 Trasmentimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale.
- 17.3.2 Komunikimin e ndersjellte ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjetere.
- 17.3.3 Mekanizma qe mundesojne procesin e votimit perpara apo gjate mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.
- 17.4 Ortaku i vetem ka te drejten, qe i njihet nga ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" apo statuti i shoqerise, per te marre unanimisht çdo vendim.

Neni 18 **Perjashtimi nga e drejta e votes**

- 18.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
- vleresimin e veprimtarise se tij;
 - shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
 - dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 18.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 19 **Procesverbali i mbledhjes se asamblese**

- 19.1 Vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procvemaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.



19.2 Provesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emerit e mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.

19.3 Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrësve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

19.3 Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 20 **Administratori**

20.1 Asambleja e pergjithshme emerit nje ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise, i cili/te cilet mund te jene Ortake ose jo dhe qe do te jene pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte rizgjedhje

20.2 Me themelimin e shoqerise, administrator i pare i saj emerohet shtetasi:

- **MEHMET BAKIU**, i biri i Ismailit dhe Fatbardhes, lindur me 24.05.1989 ne Kucove dhe banues ne Lucie Bekerdheli 00690483; Nd. 27; H. 1; Durres, Shqiperi, identifikuar me Leternjofim nr. 034547488 dhe Nr. Personal I90524076T.

20.3 Administratori i shoqerise emerohet per nje afat 5 (pese) vjeçar.

20.4 Administratoret kane te drejte e detyrohen:

- a) Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Te perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) Te kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) Te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) Te krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) Te kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) Te raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) Te kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- f) Administratori mund te emeruje perfaqesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

20.5 Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 50 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 50 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.



7

20.6 Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

20.7 Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

TITULLI IV VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

Neni 21 Viti Financiar

21.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

21.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor te te njejtit vit.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ne se jane te nevojshme dhe raportet e ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

23.4 Miratimi i te gjitha dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit.

NENI 22 Dividentet dhe Kapitalizimi i fitimeve

22.1 Permes Vendimit te Asamblese se Pergjithshme shoqeria shperndan dividentin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

a- aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;

b- shoqeria ka aktive likuide mjaftueshem per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

22.2 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme , dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14 , te Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendos per te kapitalizuar fitimet.

Neni 23 Ekspertet

23.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko financiare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

23.2 Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate te kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendime qe ka.

23.3 Eksperti/ekspertet kontabel i autorizuar mund te shkarkohet ne çdo moment sipas menyrave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

TITULLI IV SHPERBERJA-NDARJA – BASHKIMI-LIKUJDIMI



Neni 24
Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 25
Prishja e shoqerise

- 25.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
 - d) me vendim te gjykates;
 - e) per arsye te tjera te parashikuara nga legjislacioni.

Neni 26
Likuidimi i shoqerise

- 26.1 Ne rast prishje shoqeria do te likujdohet.
- 25.2 Per prishjen e shoqerise dhe administrimin e kesaj procedure, Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore duke shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- 26.3 Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.
- 26.4 Likujdatori apo likujdoret paraqisin raportet perfundimtare me shkrim mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 26.5 Me perfundimin e procedurave se likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujdusi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 26.6 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se debive, likujdatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likujdimit ortakut ose ortakeve ne propocion me pjeset e kapitalit te zoteruar prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 27
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 28
Dispozita te pergjithshme

- 28.1 Ky statut eshte hartuar ne 4(kater) kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi ju lexua ortakeve te shoqerise dhe u pranua vullnetarisht pa asnje verejtje, nenshkruhet prej tyre.
28.2 Ky statut hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKU
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SHOKO-MERT" SHPK

Mehmet Bakia

